



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:150695

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05747296

KPPP.nr.1041/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., me NUI: 811446906, me seli në Prishtinë, rruga Robert Doll” nr.99, kundër debitorëve: 1. “Prudencia Consulting” L.L.C., me NRB: 71253805, me seli në Prishtinë, rruga “Garibaldi” 17/19; 2. A.S., me adresë në rrugën “Garibaldi” 17/19, Prishtinë; 3. B.S., me adresë në rrugën “e Vushtrrisë” Tophane, Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorëve të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.233/2023 të datës 12.06.2023, të Përmbartuesit Privat Fadil I. Hoxha, me seli në Prishtinë jashtë seancës, me datë 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorëve 1. “Prudencia Consulting” L.L.C., 2. A.S., 3. B.S. dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.233/2023 i datës 12.06.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil I. Hoxha, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.233/2023 të datës 12.06.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve përmbartimore – Marrëveshjen mbi kredinë Nr.200714455 të datës 12.07.2018, dhe Marrëveshjen mbi Pengun, me të cilin janë urdhëruar debitorët që kreditorit t’ia paguajnë borxhin në shumë prej 6,635.94 €, së bashku me kamatën e rregullt dhe kamatëvonesën që do të arrij deri në pagesën definitive, ashtu që përmbartimi të realizohet me bllokimin e llogarive

bankare të debitorëve deri në pagesën e borxhit, si dhe me sekuestrimin e kolateralit të lënë peng sipas marrëveshjes mbi pengun.

Debitorët, brenda afatit ligjor kanë paraqitur prapësim, me të cilin e kanë kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se dokumentet e besueshme mbi bazën e të cilave mund të iniciohet procedura përmbarimore janë përcaktuar me nenin 29 të LPP-së, dhe se i njëjti mund të bëhet në rastet kur i bashkëngjitet dokumenti në origjinal apo kopje të vërtetuar sipas ligjit. Tutje ka shtuar se debitori ka pasur disa vonesa në pagesën e kësteve mujore por që banka ka qenë e njoftuar për gatishmërinë tonë për pagesën e kredisë, me datë 21.06.2023, debitori ka debituar në llogarinë e tij shumën prej 1,735.00 €, shumë kjo e cila ka qenë e mjaftueshme për përmbushjen e kësteve të vonuara nga ana e debitorit, përkatësisht para se debitori ta pranoj urdhrin për përmbarim. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorëve dhe të anulohet urdhri përmbarimor, si dhe të obligohet kreditori që t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka deklaruar se e kundërshton në tërësi prapësimin e debitorit, duke theksuar se debitori nuk ka paraqitur prova me të cilat do ta mbështeste prapësimin e tij. Tutje ka shtuar se pretendimi i debitorit se iniciimi i procedurës përmbarimore nuk është bërë në bazë të dokumentit të besueshëm, nuk qëndron pasi që kontrata mbi pengun e regjistruar në regjistrin zyrtarë është përcaktuar si dokument përmbarimor sipas LPP-së. Sa i përket pretendimit se kërkesa nuk është bërë e arritshme, ka theksuar se kërkesa bëhet e arritshme në momentin kur debitori bie në vonesë në pagesën e kësteve, kreditori ka të drejtë të kërkojë tërë borxhin apo shumën të cilën e kanë kontraktuar me kontratën e kredisë, andaj janë të paqëndrueshme pretendimet e debitorit, i njëjti ka për qëllim prolongimin e procedurës përmbarimore si dhe keqpërdorimin e drejtave procedurale. I ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta vërtetoj.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitur në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorëve është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, për shkaket si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbaues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbaues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Sipas nenit 22 par.1 të LPP-së, janë përcaktuar dokumentet përmbauese ndërsa me par.1 nën par. 1.7. të këtij neni, si dokument përmbaues përcaktohet: *“...kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit...”* dhe me nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaimore përcaktohet se dokument përmbaues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*, ndërsa me nenin 36 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbaues i dorëzohet edhe dokumenti përmbaues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbaueshmërisë për përmbaueshmëri”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat, gjeti se Marrëveshjen mbi kredinë Nr.200714455 të datës 12.07.2018,dhe Marrëveshjen mbi Pengun, në bazë të së cilave është mbështetur propozimi për përmbarim dhe është lejuar urdhri përmbaor janë bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar siç kërkohet me nenin 36 të LPP-së.

Në këtë drejtim, rezulton se propozimi për përmbarim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, përmban të meta ngase në propozim nuk janë treguar dokumentet origjinale apo kopje e vërtetuar mbi bazën e të cilëve është iniciuar procedura përmbaimore, ashtu siç përcaktohet edhe me dispozitën nga neni 38, paragrafi 1 të LPP-së: *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbaor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*

Sipas nenit 43, par.4 të LPP-së përcaktohet se: *“...Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbaueshmërisë së nxjerrë nga përmbauesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbaimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbauesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbauesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*

Andaj, nga të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret Urdhri mbi lejimin e përmbarrimit P.nr.233/2023 i datës 12.06.2023, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbarrim nuk i është bashkangjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumenteve përmbarrimore dhe rrjedhimisht propozimi për përmbarrim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrorit.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrorit për përmbarrim, ndërsa organi përmbarrues - përmbarruesi privat, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbarrim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarrues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi urdhrin përmbarrimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1041/23, datë 28.05.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.